



Prishtinë, 03 Nëntor 2023

Minutat e Takimit

Tema: Diskutim Publik mbi Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Projektit për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës

Vendi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Koha: 13:30 – 15:30

Ky diskutim publik u zhvillua në vijim të procesit të përgatitjes së Projektit për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës (P179656), e organizuar nga MASHTI, e cila është agjencia kryesore zbatuese për përgatitjen e projektit dhe aktivitetëve përkatëse.

Në këtë takim morën pjesë si më poshtë:

1. Mevlude Murtezi, Drejtoreshë, Kolegjiumi i Drejtorëve të Institucioneve Parashkollore të Kosovës
2. Gëzime Rexhepi Çollaku, Drejtoreshë, Asociacioni i Institucioneve Parashkollore Private të Kosovës
3. Lulavera Behluli, Koordinatore e Projektit, Save the Children
4. Dafina Krasniqi, Zyrtare për ZHFH, UNICEF
5. Shukrije Lecaj, Koordinatore Pedagogjike, CARITAS
6. Driana Sogojeva, Konsulente, MASHTI
7. Leonora Shala, Koordinatore, MASHTI
8. Isuf Gashi, Udhëheqës i Divizionit, MASHTI
9. Nita Prekazi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, MFPT
10. Aurora Osmanaj, Praktikante, MASHTI
11. Luljeta Kabashi, Zv. Udhëheqëse e DAGJ, MASHTI
12. Imrane Ramadani, Zyrtare, MASHTI
13. Reshit Kurtaj, Zyrtar i Arsimit, DKA Prizren
14. Shpresa Kastrati, Specialiste e Mjedisit, Banka Botërore
15. Labëri Luzha, Udhëheqëse e Divizionit për Edukim Parashkollor, MASHTI
16. Erjona Bajraktari, Konsulente Mjedisore, MASHTI
17. Jora Lumezi, Konsulente Sociale, MASHTI
18. Tigran Shmis, Banka Botërore (online)
19. Mjellma Rrecaj, Banka Botërore (online)
20. Mrikë Aliu, Banka Botërore (online)

Pikat e Agjendës:

13:30 -14:00

- Hapja e takimit
Avni Rexha - Drejtor i Departamentit të Arsimit Parauniversitar (MASHTI)
Labëri Luzha – Udhëheqëse e Divizionit për Edukim Parashkollor (MASHTI)
Tigran Shmis – Përfaqësues i Projektit nga Banka Botërore

14:00 -14:45

- Prezantim - Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social - Jora Lumezi dhe Erjona Bajraktari, Konsulente të Projektit (MASHTI)

14:45 –15:15

- Diskutim i Hapur

15:15 – 15:30

- Përmbledhje dhe Mbyllja e Takimit

Zhvillimi i Takimit:

- Fjalën hapëse të këtij takimi e mbajti z. Avni Rexha, Drejtor i Departamentit të Arsimit Parauniversitar në MASHTI, i cili fillimisht falenderoj Bankën Botërore për hartimin e këtij projekti. Me tutje tha se MASHTI ka prioritet edukimin e fëmijërisë së hershme, prioritet ky i cili është i paraqitur edhe në Planin Strategjik të Arsimit, dhe për këtë arsye hartimi i këtij projekti ka një rëndësi të madhe për MASHTI-n, sepse nëse zhvillohet ashtu siç e kanë paramenduar, do të vetëdisoj stafin profesional nëpër shkolla, prindërit dhe gjithë shoqërinë, për rëndësinë e edukimit të hershëm. Z. Rexha shtoi se në Kosovë, edukimi i hershëm nuk është edhe aq i zhvilluar dhe për këtë arsye beson se ky projekt do të ndihmojë shumë në këtë drejtim. Ne fund, ai falenderoj edhe konsulentet e angazhuara në këtë projekt, duke iu uruar sukses të mëtutjeshëm në vazhdimësi të këtij projekti.
- Më pas, fjalën mori Labëri Luzha, Udhëheqëse e Divizionit për Edukim Parashkollor në MASHTI, e cila falenderoj partnerët për dizajnimin e projektit për edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili ka të bëjë me kapitalin njerëzor. Ajo gjithashtu falenderoj edhe pjesëmarrësit e këtij konsultimi publik që gjetën kohë të vijnë dhe të diskutojnë komponentën e menaxhimit social dhe mjedisor. Ajo tha se Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, synon të marrë fonde nga Banka Botërore për zbatimin e Projektit për “Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës”. Tutje tha se objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në vend, duke shtuar se ky projekt është i strukturuar për t’iu përgjigjur çështjeve kryesore të shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë.
- Znj. Luzha tha se në MASHTI kanë punuar shumë këto vitet e fundit në lidhje me ZHFH, dhe ky projekt vjen në momentin më të mirë, sepse këtë vit në muajin Gusht, Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, dhe përtej ligjit, departamenti ka filluar tashmë edhe procesin e hartimeve të Udhëzimeve Administrative për ta jetësuar këtë ligj, duke përfshirë ketu Udhëzuesin për të Ushqyerit e Shëndetshëm të Fëmijëve në institucione parashkollore, si dhe janë në finalizim të dokumentit bazë i cili do të ndryshojë dhe përmirësoj cilësinë e edukimit të hershëm në nivel vendi, i cili është Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Udhëheqësja e Divizionit tha se ky projekt është brenda Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe poashtu brenda Strategjisë së Arsimit 2022-2026, kështu që të gjitha këto politika të reja në lidhje me ZHFH të cilat asnjëherë nuk kanë qenë kaq të mëdha, do të shtrihen në katër komponenta të këtij projekti, dhe

së bashku me grupin punues të themeluar nga MASHTI, do të prekin çështjet kryesore dhe do të ndihmojnë vendin me këtë projekt, i cili në vlerë monetare është më i madhi që ka ndodhur ndonjëherë për ZHFH në Kosovë.

- Në vijim, Luzha tha se me Ligjin e ri kanë paraparë shumë çështje të reja të cilat do e ndihmojnë edukimin në fëmijëri dhe hershme, siç është zgjerimi i përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore dhe rritja e cilësisë, si dhe do të provojnë të zgjerojnë hapësirat egzistuese parashkollore, rimodelojnë kopshtet egzistuese dhe të shtojnë një formë të re të edukimit, e cila është krijimi i kopshteve modulare. Luzha tha se Qeveria e Kosovës po punon shumë në lidhje me ZHFH, në bashkëpunim me partnerët të cilët edhe janë të pranishëm sot, duke përfshirë UNICEF, Save the Children, CARITAS-in e Zvicrës, dhe Bankën Botërore, me të cilët është e planifikuar edhe dizajnimi dhe ndërtimi i 47 kopshteve të reja në nivel vendi, për një periudhë 5 vjeçare. Në vazhdimësi, ajo shtoi se Ligji i ri ka paraparë nene të reja të cilat do të zhvillohen, përfshirë këtu edhe koordinimin ndërsektorial, një fushë e re të cilën me projektin e BB po synojnë që ta rregullojnë apo të paktën ta përmirësojnë në Kosovë. Për këtë çështje ajo tha se do të jetë një sfidë, por jo e pamundur, përshkak se do të kenë mundësi të komunikojnë dhe bashkëpunojnë edhe me ekspert ndërkombëtar e dhe ata më të mirët e vendit tonë, me qëllim të mbështetjes holistike të fëmijëve në moshën e hershme, në tre komponente të rëndësishme: shëndetin, mirëqenjen dhe edukimin.
- Luzha përmendi edhe disa pjesë të tjera që përmban ky Ligj i ri, si aftësimi i dadove për prindërit që nuk kanë mundësi t'i dërgojnë fëmijët në institucione parashkollore, si një alternativë tjetër e re. Më tutje, ajo vazhdoi me përmendjen e komponentëve të këtij projekti, të cilat janë: 1) Forcimi i cilësisë dhe barazisë së shërbimeve për ZHFH në Kosovë, 2) Nxitja e integritit shumë-sektorial në ofrimin e shërbimeve për ZHFH, 3) Rritja e aksesit në shërbimet e ZHFH, dhe 4) Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit.
- Në vijim, mori fjalën përfaqësuesi i BB-së, z. Tigran Shmis. Përfaqësuesi i projektit nga ana e BB-së, tha është një nder i madh të flas para këtij publiku, duke shprehur të kenë një diskutim të frytshëm. Z. Shmis vazhdoi duke thënë se në emër të të gjithë ekipit të Bankës i përgëzojnë për nisjen e këtyre hapave përfundimtarë të dorëzimit dhe përgatitjes së projektit, duke shtuar më tej se ky projekt po adreson nevojën urgjente në vend, e cila është aksesit për edukim cilësor të fëmijërisë së hershme dhe shërbime të kujdesit për familjet në Kosovë. Ai shtoi se Kosova qëndron pak më poshtë se vendet e tjera të rajonit sa i përket çasjes në shërbime cilësore të arsimit të hershëm dhe për këtë arsye kur e hartuan projektin së bashku me MASHTI-n, ata tërhoqën shumë këshilla ndërkombëtare për punën që bënë.
- Z. Shmis deklaroi se në këtë projekt po fokusohen edhe tek cilësia edhe aksesit, dhe në këtë rast aksesit është ajo që u jep fëmijëve hapësira për të shkuar në kopshte, por edhe kur shërbimet janë në cilësinë më të lartë, atëherë shikon rezultatet më të mira tek fëmijët, veçanërisht më vonë në jetë, siç janë performanca e lartë në tregun e punës dhe në përgjithësi një cilësi më e mirë e jetës. Ai shtoi se investimi i hershëm në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve i ndihmon ata të bëhen individë të suksesshëm më vonë në jetë dhe për këtë arsye titulli i këtij projekti përmban kapitalin njerëzor. Z. Shmis tha se kur Kosova pranoi të investojë tek fëmijët e vegjël të vendit, do të thotë se Kosova po investon në të ardhmen e këtij vendi, që është thelbësore edhe në zhvillimin ekonomik. Ai tha se ky investim i projektit, gjithsej 22 milionë euro, do të përkthehet më vonë në rezultate shumë më të mëdha, prandaj nuk e konsiderojnë si një shpenzim por investim për Kosovën.

- Përfaqësuesi i BB-së foli edhe për komponentët e projektit dhe ndikimin e tyre në shoqëri, deri sa përmendi një aktivitet të veçantë të projektit që janë grantet komunitare – ku të gjitha komunitat do të kenë të drejtë të marrin pjesë në këtë konkurs. Ai shtoi se me këtë aktivitet do të kenë mundësinë të kuptojnë se si shoqëria dhe komunitetet në veçanti e shohin ZHHF-në, cilat janë problemet e tyre, nivelet e kënaqësisë, idetë, anët negative, anët pozitive të projektit, etj. Ai gjithashtu tha se projekti do të kryejë disa studime për shërbime cilësore në vend, çfarë bëjnë mësuesit, çfarë nuk bëjnë, çfarë duhet të bëjnë, e kështu me radhë. Për më tepër, këto studime do të përfshijnë edhe rezultatet e fëmijëve nëpër insitucione parashkollore. Z. Shmis në fund përmendi se këto janë vetëm hapat fillestarë të projektit, pasi që duhet fillimish të dërgohet tek menaxhmenti i lartë i BB-së, e pastaj të miratohet edhe në Kuvendin e Kosovës, e më pas do të nënshkruhet marrëveshja që realisht e nis këtë projekt.
- Erjona Bajraktari, e angazhuar nga MASHTI si konsulente për përgatitjen e dokumenteve të projektit në lidhje me kornizën mjedisore dhe sociale, filloi me prezantimin e dokumenteve bazë: Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS), cili ka për qëllim të shmangë, minimizojë ose zbusë ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe sociale të lidhura me zbatimin e projektit; Korniza e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), i përgatitur me qëllim që të ofrojë politika dhe procedura për të shmangur dhe minimizuar nevojat e projektit për të përvetësuar toka me pronësi private dhe si rezultat mos të ketë ndikime në humbjen e të ardhurave të palëve që mund të preken; Procedurat e Menaxhimit të Punës (LMP), dokument që mundëson identifikimin e kërkesave kryesore të punës dhe risqeve të lidhura me të dhe ndihmon huamarrësit të përcaktojnë burimet e nevojshme për të adresuar çështjet e punës; si dhe Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP), i cili ka për të aktivizojë angazhimin e palëve të interesuara në kohën e duhur gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projektit. Znj. Bajraktari tregoi se tani do të vazhdoj me prezantimin e dy dokumenteve të para, KMMS dhe KPZH, ndërsa kolegja e saj, do të prezantoj dy dokumentet e tjera, LMP dhe SEP.
- Konsulentja mjedisore e projektit tha se ndikimet e përgjithshme të pritshme nga implementimi i plotë i projektit priten të jenë pozitive në aspektet sociale. Gjithashtu, Bajraktari shtoi se zbatimi i punimeve sipas komponentit 3, duke përfshirë këtu rikonstrukcionin e godinave ekzistuese, risistemimin e hapësirave parashkollore ekzistuese si dhe ndërtimin e kopshteve të reja, mund të shoqërohen me impakte mjedisore dhe sociale të mesme, të karakterit të përkohshëm dhe lokal, të cilat mund të shmangen apo të zvogëlohen lehtësisht nëpërmjet aplikimit të masave mbrojtëse sipas udhëzimeve të standardeve të BB, politikave të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të BB, si dhe respektimit të kuadrit ligjor mjedisor dhe social të Republikës së Kosovës. Ajo tha se impakti kryesor social i cili duhet të mbahet parasysh gjatë zbatimit të projektit në mënyrë që të shmangët maksimalisht, lidhet dhe riskun e mos përfshirjes së grupeve në nevojë dhe të disavantazuar, duke mos i dhënë mundësinë të përfitojnë nga projekti. Bajraktari për këtë pjesë shtoi se niveli i ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit të cilat do të lidhen kryesisht me fazën e zbatimit të punimeve të parashikuara sipas komponentit 3, vlerësohet të jetë i mesëm.
- Më tutje, Znj. Bajraktari e prezantoi përmbajtjen e dokumentit të Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social, për të cilin tha se është një parashtrim i përgjithshëm, i bazuar në politikat, rregulloret dhe ligjet mjedisore, e cila paraqet një investigim të detajuar të ligjeve të cilat janë aktualisht në fuqi në Kosovë si përputhja me standardet e BB-së. Ajo tregoi se MASHTI do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm, koordinimin, monitorimin e rezultateve dhe komunikimin me BB-në për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me projektin. Gjithashtu,

shtoi se një Njësi Qendrore për zbatimin e Projektit (NJZP) do të krijohet brenda MASHTI-it, e cila do të ofroj asistencë teknike dhe operacionale për MASHTI-n dhe Qarqet/Komunat e synuara në zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë funksione si prokurimin, menaxhimin financiar dhe do të mbaj përgjegjësinë e menaxhimit të ndikimeve mjedisore dhe sociale.

- Më tutje, Bajraktari vazhdoi me prezantimin e dokumentit të dytë, Korniza e Politikave të Zhvendosjes, e cila përmban udhëzime dhe procedura për të minimizuar humbjet e tokave dhe asetëve private, si dhe humbjen rezultante të të ardhurave që vjen si shkak i zbatimit të projektit. Ajo gjithashtu tha se ndikimet e pashmangshme duhet të trajtohen me masa zbutëse që do të jenë të mjaftueshme për të rikthyer nivelin e jetesës së personave të prekur, në nivelin që ishte para zbatimit të projektit. Duke e përmbyllur, konsulentja tha se në rast të ndonjë mangësie ndërmjet kuadrit ligjor Kosovar dhe Standardeve të Bankës Botërore për Zhvendosjen e Pavullnetshme apo mospërputhjeje, dispozitat e RPF-së (Kornizës së Politikave të Zhvendosjes) do të mbizoterojnë dhe do të jenë pjesë e marrëveshjes ligjore të nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore në kuadër të financimit të projektit.
- Pastaj mori fjalën konsulentja e projektit për çështje sociale, Jora Lumezi, e cila prezantoi dokumentet e fundit, LMP dhe SEP. Lumezi tregoi se dokumenti Procedurat e Menaxhimit të Punës ka për qëllim t'i adresoj rreziqet e mundshme të punës, të cilat janë cilësuar si të moderuara dhe fokusohen në shëndetin dhe sigurinë në punë, duke përfshirë shqetësimet për COVID-19. Ajo tha se në këtë dokument, theks të madh kanë vënë tek ndërgjegjësimi për dhunën me bazë gjinore, ngacmimet, si dhe sfidat e ngarkesës së punës. Gjithashtu, dokumenti thekson një angazhim për të adresuar këto rreziqe dhe për të siguruar praktika të drejta, siguri dhe pajtueshmëri me rregulloret e punës. Më tutje, Lumezi tha se LMP ofron edhe një përmbledhje të legjislacionit të punës, duke u fokusuar në tre fusha kryesore: Legjislacioni Kombëtar: Ligji për Punën (03/L-212) në Kosovë; Dispozitat Ligjore për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë: Ligji i Kosovës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (04/L-161); si dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (ESS2). Sipas Lumezit, projekti vë theks të madh trajtimin e drejtë, parandalimin e diskriminimit dhe sigurimin e mundësive të barabarta për fuqinë punëtore. Konsulentja e MASHTI tha se një pjesë integrale e LMP-së është edhe Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave, që do të shërbejë si një platformë e unifikuar për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve për punëtorët e angazhuar një projekt. Ajo tregoi se ky mekanizëm do të përfshijë një përcaktim të qartë se kë duhet të kontaktojnë punonjësi për të paraqitur një ankesë; përcaktim të kornizës kohore brenda së cilës do të adresohet ankesa; lejimin e punonjësit të përshkallëzojë ankesën në një nivel më të lartë organizativ; dhënia e të drejtës për të pasur përfaqësim; sigurimi i mbrojtjes kundër çdo forme hakmarrjeje; mos pengimi i qasjes në mjetet juridike; si dhe mundësimi i paraqitjes dhe adresimit të ankesave anonime. Në fund, Lumezi tha se punëtorët mund të refuzojnë të punojnë nëse rrezikohet siguria ose mirëqenia e tyre, ose nëse mungojnë masat e duhura shëndetësore dhe të sigurisë.
- Më tutje, Lumezi vazhdoi me dokumentin e fundit, Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit, i cili sipas Lumezit shërben për qëllimet e mëposhtme: i) identifikimin dhe analizën e palëve të interesuara; ii) planifikimin e modaliteteve të angazhimit dhe mjeteve efektive të komunikimit për konsultime dhe zbulim; iii) përcaktimin e rolit dhe përgjegjësi të aktorëve të ndryshëm në zbatimin e SEP; iv) përcaktimin e mekanizmit të ankesave të projektit; v) ofrimin e reagimeve për palët e interesuara; si dhe vi) monitorimin dhe raportimin e SEP. Ajo tha se ky plan ndan palët e interesuara të projektit në tri kategori: Palët e prekura nga projekti, palë të tjera të interesuara dhe individë ose grupe të pafavorizuara/vulnerabël. Gjithashtu, Lumezi tregoi se sipas

këtij dokumenti, projekti i ka njohur këta aktorë si pjesëmarrës kryesorë në ekzekutimin e tij: Autoritetet Lokale dhe Rajonale; Kompanitë dhe Shoqatat Private; Stafi Parashkollor dhe Komunitetet Lokale; Qeveria dhe Organet Rregullative; Organizatat Joqeveritare dhe Organizatat Ndërkombëtare; dhe Individë ose grupe të pafavorizuara/ vulnerabël. Ajo vazhdoi duke thënë se ky plan ka objektiva të ndryshme, disa nga to përfshijnë pajtueshmëri me kërkesat ligjore të Kosovës dhe përputhjen me standardet e BB-së, identifikimin e palëve kryesore të interesit, sigurimin e komunikimit efektiv, adresimin e ankesave, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi, etj. Më pas, ajo tha se një komponent integral i këtij plani është edhe krijimi i një mekanizmi për zgjidhjen e ankesave, ngjashëm si tek dokumenti i mëparshëm, i cili përmban një platformë online dhe regjistrin e ankesave, qëllimi i të cilit është të informojë të gjithë aktorët përkatës për procedurat për paraqitjen e ankesave në lidhje me aktivitetet e projektit dhe të sigurojë përgjigje në kohë për shqetësimet e mundshme të tyre.

- Pas prezantimit të këtyre katër dokumenteve kyçe të projektit, në kuadër të kornizës sociale dhe mjedisore, filluan pyetjet dhe diskutimi i hapur me pjesëmarrësit. Diskutimi i hapur nisi nga znj. Luzha nga MASHTI e cila tha se këto dokumente të përgatitura do të ndahen fillimisht në diskutimin e brendshëm publik, më saktësisht me institucionet varëse të Qeverisë së Kosovës, e pastaj do i ndajmë edhe më të gjithë të tjerët, apo publikun, për të dëgjuar mendimet edhe të atyre që nuk janë prezent sot, për të marrë komente, ide, në mënyrë që këto dokumente të jenë sa më të plota.
- Më pas, fjalën mori Lulavera Behluli, Koordinatore e Projektit në Save the Children, e cila fillimisht përgëzoi Divizionit për Edukim Parashkollor për punën e bërë dhe për iniciimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për vendin. Ajo tha se shumë me rëndësi është komponenta e cilësisë së edukimit parashkollor për të cilën ky projekt duhet ta ketë prioritet. Më tutje, znj. Behluli tha se MASHTI por edhe të gjithë partnerët kanë një synim të përbashkët në lidhje me ZHFH, e cila është rritja e përfshirjes së fëmijëve nëpër institucione parashkollore. Ajo tregoi se raporti i fundit PISA-së ka thënë se ata fëmijë që kanë vijuar edukimin parashkollorë nuk janë treguar më të mirë krahas atyre që nuk kanë qenë në një institut parashkollor, prandaj rritja e cilësisë së edukimit parashkollor është kyç për zhvillimin e duhur të fëmijëve. Znj. Behluli gjithashtu tha se bashkëpunimi ndërsektorial është shumë i rëndësishëm për një projekt të tillë, të ketë sinergji të përbashkët nga të gjitha palët e interesit dhe të punojnë të gjithë së bashku për rezultate më të mira.
- Në vijim, Isuf Gashi nga MASHTI, gjithashtu pjesë e grupit punues, tha se duhet të trajtohet edhe një çështje shumë e rëndësishme: ndërtimet rurale, ndërtimet modulare si dhe adaptimet e qerdheve. Ai shtoi se projekti duhet të jetë më i detajuar sa i përket lokacioneve, çështjes së pronave – duke marrë parasysh se lejet e ndërtimit nuk lëshohen nëse prona nuk është e shëndrruar në pronë komunale. Sipas z. Gashi sfida më e madhe e këtij projekti do të jetë siguri i lokacioneve, të cilat duhet zgjedhur nga ekspertet, si dhe ndikimi mjedisor dhe social nëpër zona urbanistike dhe rurale ku do të bëhen ndërtimet përkatëse. Në lidhje me gjetjen e lokacioneve, znj. Luzha tha se do të kenë bashkëpunim të ngushtë gjatë gjithë kohës me komunat në nivel lokal, të cilat gjithashtu kanë prioritet ZHFH, krahas punësimit të femrave dhe aspekteve tjera sociale, prandaj beson se çështja e lokacioneve do të shkoj mirë dhe zgjidhjet do të bëhen lehtësisht. Më pas, në lidhje me çështjet e tjera të ngritura nga z. Gashi u tha se të gjitha detajet e impaktit në mjedis rreth konstruksioneve do të jenë në dokumentet e përgatitura nga konsulentet e projektit, të cilat do të ndahen me pjesëmarrësit dhe publikun e gjerë. Gjithashtu, nga znj. Bajraktari u tha

se detajet specifike rreth lokacioneve, shpronësimit, etj - do të përcaktohen gjatë fazave të ardhshme të projektit.

- Pika tjetër e diskutimit u hap nga Mevlyde Myrtezi, Drejtoreshë në Kolegjiumin e Drejtorëve të Institucioneve Parashkollore të Kosovës, e cila tha se diçka tjetër që sipas saj është shumë e rëndësishme është hulumtimi i gjendjes së ZHFH në nivel vendi, duke u bazuar se në çfarë ka nevojë vendi jonë. Znj. Myrtezi shtoi se e sheh të arsyeshme të ndalet në dy elemente të përmendura gjatë këtij diskutimi, përkatësisht tek komponenta një dhe dy, ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për ZHFH si dhe promovimi i ushqyerjes së shëndetshme të fëmijëve. Ajo tha se meqenëse përvoja saj për ZHFH është e bazuar nga puna në terren, ajo ka parë nevojën urgjente për përmirësimin në këto dy elemente, sidomos nëpër zona rurale, prandaj kërkon nga përfaqësuesit e këtij projekti t'i kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre dy pikave të përmendura. Znj. Luzha tha se janë të vetëdijshëm që Kosova qëndron mangët në këto dy aspekte, dhe për këtë arsye projekti do t'i adresojë këto problematika, sidomos shëndetin e fëmijëve, së pari duke bërë një analizë të thukët për të parë se për çfarë saktësisht ka nevojë të intervenohet nëpër kopshtet e komunave të Kosovës. Ajo gjithashtu shtoi se tashmë veç kanë hartuar një udhëzim administrativ në lidhje me të ushqyerit e shëndetshëm, si dhe kanë hartuar edhe menu-të e reja të ushqimit së bashku me ekspertë të kësaj çështje.
- Më pas, fjalën mori Gëzime Rexhepi Çollaku, Drejtoreshë e Asociacionit të Institucioneve Parashkollore Private, e cila ngriti pyetjen se çfarë do të ndodhë në vazhdimësi me institucionet parashkollore private. Ajo tha se deri më tani, këto kopshte kanë rritur përfshirjen e fëmijëve në edukimin e fëmijërisë së hershme, mirëpo janë gjithmonë të rrezikuara nga shuarja dhe nën presion. Prandaj, znj. Rexhepi Çollaku dëshiron të dijë se cili do të jetë bashkëpunimi i ardhshëm me këto institucione private, qoftë iniciativë nga Banka Botërore apo nga Qeveria e Kosovës, sepse sipas saj deri më tani nuk kanë pasur mbështetje nga shteti i Kosovës. Për këtë çështje, znj. Luzha tha se mbi 200 kopshte private në nivel vendi janë të licensuara, dhe mu për këtë arsye, përmes UNICEF, u krijua Asosacioni i Institucioneve Parashkollore Private, në mënyrë që të koordinohen në mes vete, të fuqizohen, etj. Me projektet të MASHTI, përfshirë edhe projektin e BB-së, do të përfshijmë ngrijten e kapaciteteve të të gjithë stafit edukativ nëpër kopshte parashkollore në nivel vendi, ata të punësuar në institucione publike si dhe private. Gjithashtu, ajo tregoi se me këtë projekt do punojnë edhe në hartimin e udhëzimeve të reja administrative, ku sigurisht do të përfshihet edhe mbështetja e sektorit privat nga Qeveria e Kosovës në lidhje me ZHFH, ku në hartim do të përfshihen edhe akterët e sektorit privat. Për fund, ajo tha se egziston një frymë shumë pozitive që ky bashkëpunim të thellohet edhe më shumë dhe këto institucione të përfshihen edhe në vendimmarrje dhe të dëgjohen zërat e të gjitha palëve.
- Në vijim, Leonora Shala nga MASHTI, gjithashtu përmendi rëndësinë e madhe të shëndetit të fëmijëve. Ajo tregoi se si grup përmbrenda MASHTI-të kanë ngritur zërin dhe po punojnë në këtë drejtim. Znj. Shala përmendi edhe hartimin e udhëzimit administrativ i cili u bë për herë të parë në lidhje me të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve nëpër kopshte, përmendi menu-të e reja të financuara nga UNICEF, planprogramin edukativ ku ushqimi është vendosur si një pjesë integrale, e të tjera. Ajo për fund tha se gjithmonë janë të hapur për komente dhe ide, në mënyrë që të zhvillohen edhe më shumë në këtë aspekt, duke shtuar se të gjithë shqetsimet do mundohen t'i adresojnë në mënyrë holistike.

- Në anën tjetër, Luljeta Kabashi nga Divizioni për Fëmijë me Nevoja të Veçanta në MASHTI tha se do të ishte mirë që ky projekt të marrë parasysh edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Ajo tha se është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme për vendin tonë të intervenohet tek këta fëmijë nëpër institucione parashkollore. Ajo vazhdoi duke thënë se përgatitja e edukatorëve që të kenë njohuri të bollshme në çasjen ndaj fëmijëve, përkujdesjen si dhe aftësimin e tyre, është kyç që këta fëmijë të kenë një jetë të pavarur në të ardhmen. Znj. Luzha tha se me këtë projekt do prekin identifikimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe uljen e vdekshmërisë tek fëmijët. Më tutje ajo tha se gjithashtu të gjitha ndërtimet do t'i përshtaten standardeve të infrastrukturës egzistuese të MASHTI, të cilat do të rishikohen me anë të këtij projekti, në mënyrë që të jenë sa më të përditësuara dhe në favor të fëmijëve. Luzha përmendi një shembull, duke thënë se tani shumë kopshte nuk kanë ashensor, dhe elemente të tilla do i adresojnë me projektin e BB-së.
- Diskutimi publik u mbyll nga znj. Luzha duke falenderuar të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë. Ajo tha se MASHTI do të vazhdoj koordinimin me partnerët, të cilët edhe janë prezent në këtë konsultim, në lidhje me aktivitetet e parapara në kuadër të këtij projekti, si dhe shtoj se dokumentet e përgatitura do të përditësohen në bazë të komenteve të marra gjatë këtij takimi.